VENDIM
Nr. 237, datë 20.8.2026

MBI PEZULLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE, LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË "ERSEKA SOLAR PARK 1" SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike"; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të nenit 14, pika 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1082/29 prot., datë 19.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Erseka Solar Park 1' sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw",

konstatoi se:

- Shoqëria "Erseka Solar Park 1" sh.p.k., e licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1082 prot., datë 3.4.2026, ka paraqitur kërkesën për modifikim, ndryshim në aneksin A të kësaj licence, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/ depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 20 mw.
- Në vijim të këtij aplikimi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 110, datë 21.4.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure në datat 22.4.2026 dhe 23.4.2026. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresat nr. 1082/4 prot., datë 24.4.2026 dhe nr. 1082/9 prot., datë 1.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet në këtë aplikim. Shoqëria ka kthyer përgjigje përkatësisht me shkresat nr. 1082/5 prot., datë 14.5.2026, nr. 1082/6 prot., datë 20.5.2026 dhe nr. 1082/10 prot., datë 8.6.2026.
- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1082/3 prot., datë 24.4.2026. Nga ana e AKM-së dhe OST-së nuk rezulton të ketë pasur ndonjë qëndrim, në lidhje me këtë procedurë.
- Brenda afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta janë paraqitur objeksione nga z. A. Q. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 175, datë 22.6.2026, zgjati me 30 ditë afatin e vendimmarrjes për shqyrtimin e objeksioneve dhe parashtrimeve të shoqërisë mbi to.
- Në vijim, MIE, me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, ka bërë me dije se çdo ndryshim në projekt, përfshirë shtimin e veprave ndihmëse apo njësive të depozitimit të energjisë, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke kërkuar që ky qëndrim të mbahet në konsideratë nga ERE në procedurat përkatëse të modifikimit të licencave.

- ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 1082/17 prot., datë 14.7.2026, me anë të së cilës e ka njoftuar për shkresën e MIE-s, si dhe i ka kërkuar depozitimin në ERE të qëndrimit të MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Referuar sa më sipër, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 200, datë 21.7.2026, vendosi të pezullojë procedurën deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE nr. 1082/22 prot., datë 29.7.2026.

- MIE, me shkresën nr. 4755/10 prot., datë 3.8.2026, protokolluar në ERE me nr. 1082/24 prot., datë 5.8.2026, ka sqaruar se për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt koncesioni, zbatohen rregullat dhe procedurat e VKM-së nr. 822/2015, të ndryshuar. Në këtë shkresë, ajo sqaron, ndër të tjera, se në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", është parashikuar një regjim kalimtar për impiantet e depozitimit të energjisë elektrike, të cilat në datën e hyrjes në fuqi të ligjit kanë qenë në zhvillim e sipër ose në operim, pa qenë të pajisura me licencë të posaçme për këtë veprimtari. Për sa më sipër, MIE vlerëson se shoqëria "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. mund të vijojë operimin sipas licencës ekzistuese gjatë periudhës tranzitore, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026.

- Me administrimin nga ERE të qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, vlerësohet se është përmbushur qëllimi dhe kushti mbi të cilin është bazuar pezullimi i procedurës, sipas pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 200, datë 21.7.2026. Për rrjedhojë, kushti i përcaktuar në këtë pikë konsiderohet i ezauruar në kuadër të këtij pezullimi.

- Pas administrimit të këtij qëndrimi, në kuadër të procedurës janë administruar rrethana të reja që lidhen me kërkesat e paraqitura pranë MIE-s për ndryshimin e kuadrit autorizues të projektit dhe të kontratës nr. 110 rep., nr. 31 kol., datë 13.1.2023, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k., për sa i përket përfshirjes në projekt të njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Në protokollin e ERE-s është administruar shkresa e z. A. Q., protokolluar në ERE me nr. 1082/25 prot., datë 12.8.2026, drejtuar MIE-s, në cilësinë e autoritetit kontraktor, në të cilën paraqiten kundërshtimet e tij lidhur me kërkesën e shoqërisë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, për shtimin e impianteve të depozitimit të energjisë. Në këtë shkresë kërkohet verifikimi nga MIE i përmbushjes së kushteve ligjore dhe kontraktore për ushtrimin e veprimtarisë së lidhur me impiantet e depozitimit të energjisë dhe kërkesat e nenit 51, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", duke parashtruar nevojën për ndryshimin e statutit të shoqërisë, të VKM-së nr. 400, datë 9.6.2022, dhe të kontratës me MIE-n nr. 110 rep., nr. 31, kol., datë 13.1.2023, si dhe për pajisjen me dokumentacion të vlefshëm mjedisor dhe ndërtimor.

- Pretendimet e paraqitura, lidhur me nevojën për ndryshimin e VKM-së nr. 400, datë 9.6.2022, të kontratës së lidhur ndërmjet MIE-s dhe shoqërisë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k., si dhe çështjet që lidhen me dokumentacionin mjedisor dhe lejet përkatëse, pasqyrohen dhe merren në konsideratë në këtë procedurë si pjesë e dokumentacionit të administruar, pa përbërë konstatime apo vlerësime të ERE-s mbi bazueshmërinë e tyre. Shqyrtimi dhe vlerësimi i këtyre çështjeve u përket organeve kompetente, sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë dhe kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

- Nga ana tjetër, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1082/26 prot., datë 17.8.2026, dhe nr. 1082/27 prot., datë 18.8.2026, shoqëria "Erseka Solar Park 1" sh.p.k. shprehet se në vijim të shkresës së MIE-s nr. 4755/10 prot., datë 3.8.2026, ajo vlerëson se tashmë është përmbushur kërkesa për marrjen e qëndrimit të MIE-s e si e tillë nuk ekziston më shkaku që solli pezullimin e përkohshëm.

- Për sa më sipër, pavarësisht qëndrimit të shprehur nga MIE me shkresën nr. 4755/10 prot., datë 3.8.2026 dhe sa referuar në shkresën e shoqërisë të datës 17.8.2026, nga dokumentacioni i administruar rezulton se pranë MIE-s është paraqitur një kërkesë tjetër, që lidhet me ndryshimin e VKM-së nr. 400, datë 9.6.2022 dhe të kontratës së nënshkruar me të në kuadër të përfshirjes së njësive të depozitimit të energjisë dhe pajisjen me lejet e tjera. Në këto kushte, marrja e qëndrimit nga MIE, në cilësinë e autoritetit kontraktor, mbi këto kërkesa dhe ndikimin e tyre në marrëdhënien kontraktore me shoqërinë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k., vlerësohet e nevojshme për shqyrtimin dhe vendimmarrjen e Bordit të ERE-s mbi kërkesën për modifikimin e licencës.

- Për rrjedhojë, duke qenë se rrethanat e mësipërme janë të reja dhe të dallueshme nga shkaku që kishte përligjur pezullimin e mëparshëm, si dhe lidhen me çështje për zgjidhjen e të cilave është kompetent një organ tjetër dhe që ndikojnë në vendimmarrjen e ERE-s, mbi kërkesën për modifikimin e licencës, vlerësohet i nevojshëm pezullimi i procedurës, në mbështetje të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe nenit 14, pika 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Në këto kushte, vlerësohet se shkaku që kishte përligjur pezullimin e mëparshëm të procedurës, të vendosur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 200, datë 21.7.2026, është ezauruar me administrimin e shkresës së MIE-s nr. 4755/10 prot., datë 3.8.2026. Megjithatë, pas administrimit të këtij qëndrimi, në kuadër të procedurës janë paraqitur rrethana të reja që lidhen me kërkesat drejtuar MIE-s për ndryshimin e kuadrit autorizues të projektit dhe të kontratës nr. 110 rep., nr. 31 kol., datë 13.1.2023, të lidhur ndërmjet MIE-s dhe shoqërisë "Erseka Solar Park 1" sh.p.k., për përfshirjen në projekt të njësive të depozitimit të energjisë elektrike. Vlerësimi dhe vendimmarrja mbi këto çështje nuk i përkasin kompetencës së ERE-s, por, në masën që lidhen me përcaktimin e konfigurimit të projektit të autorizuar dhe me mundësinë e përfshirjes në të të njësive të depozitimit të energjisë elektrike, ndikojnë drejtpërdrejt në shqyrtimin e kërkesës për pasqyrimin e këtyre njësive në aneksin A të licencës së prodhimit. Për rrjedhojë, administrimi i aktit, vendimmarrjes ose qëndrimit përfundimtar të MIE-s, sipas kompetencës së saj, mbi këto çështje vlerësohet si parakusht për vijimin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s dhe përbën një rrethanë të re e të dallueshme nga ajo që kishte përligjur pezullimin e mëparshëm. Ndërkohë konstatohet se përcaktimi nga MIE, në cilësinë e autoritetit kontraktor, nëse përfshirja e njësive të depozitimit të energjisë në projekt kërkon ndryshimin e kuadrit autorizues të projektit dhe/ose të kontratës nr. 110 rep., nr. 31 kol., datë 13.1.2023, dhe nëse këto njësi mund të përfshihen në projektin e autorizuar në kushtet aktuale përbën një çështje paraprake për pezullimin e procedurës në kuptim të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodit i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se: "nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (çështja paraprake), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.".

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë procedurën administrative për modifikimin e licencës së shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023 për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit, deri në administrimin e aktit, vendimmarrjes ose qëndrimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi çështjet që lidhen me kuadrin autorizues të projektit dhe zbatimin apo nevojën për ndryshimin e kontratës nr. 110 rep., nr. 31 kol., datë 13.1.2023, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., në lidhje me përfshirjen në projekt të njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

2. Me administrimin në ERE të aktit, vendimmarrjes ose qëndrimit të MIE-së, sipas pikës 1 të këtij vendimi, procedura administrative rifillon dhe Bordi i ERE-s vijon shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. dhe MIE-n për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti